REKO

Circular Economy Kosovo

Sweden Sverige

EICSOK

RILINDJA GJELBËR

RAST STUDIMI:
IZOLIMI PLAST – PIONIER I RICIKLIMIT TË PLASTIKËS DHE ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË SË NDËRTIMIT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Izolimi Plast është një ndërmarrje kosovare e themeluar në vitin **2015**, me selí në **Obiliq**, që ka ndërtuar një profil të qëndrueshëm në fushën e ndërtimtarisë dhe riciklimit të plastikës, me fokus të veçantë në riciklimin e **Low Density Polyethylene (LDP)**. Duke operuar me një staf prej **22 punëtorësh** dhe një cikël pune **24/7,** kompania ka investuar në rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe zhvillimin e produkteve ndërtimore nga plastika e ricikluar, duke kontribuar njëkohësisht në **ekonominë qarkore dhe rrajtjen e mjedisit.**

SFIDA DHE FILLIMET: SIGURIMI I QËNDRUESHËM I LËNDËS SË PARË PËRMES RICIKLIMIT

Që nga filimi i veprimtarisë, sfida kryesore e Izolimi Plast ka qenë sigurimi i lëndës së parë LDP për shkak të kostos së lartë dhe paqëndueshmërisë. Si zgjidhje, kompania ka adoptuar riciklimin e LDP-së për të mbuluar nevojat e saj të brendshme. Kjo iniciativë strategjike e transformoi modelin e biznesit dhe hapi rrugë për një pozicionim të fortë në industrinë e riciklimit në Kosovë.

PROCESI I RICIKLIMIT TEK IZOLIMI PLAST

Furnizimi me material
Plastika e përdorur, kryesisht najlona nga paketimi dhe transporti, bëhet nga kompani grumbullimese, markete dhe vende ndërtimi.

Presimi dhe klasifikimi
Mbetjet vijnë të presuara në formë kubash për të reduktuar volumin dhe koston e transportit, më pas klasifikohen sipas përbërjes dhe cilësisë.

Grimcimi dhe larja
Materiali grimcohet dhe pastrohet në një, duke u ndarë nga papastërtitë dhe substancat e padëshirueshme.

Tharja dhe shkrirja
Pas tharjes, LDP kalon nëpër procesin e ekstrudimit, ku shndërrohet në regranulat të cilat përdoren për prodhim të mëtejmë ose eksportohen.

Prodhimi final
Regranulat shndërrohen në produkte ndërtimore si: membrana ndërtimi, najlona për izolim, distancera për beton, etj.

KAPACITETET DHE RRITJA

- Kapaciteti aktual i riciklimit: **150-200 ton në muaj**
- Kapaciteti i pritshëm pas investimeve të reja: deri në **400 ton në muaj**, që do të përfshijë edhe llojet tjera të plastikës si High Density Polyethylene (HDP),
- Investimet e kryera deri më tani: **4–5 milionë euro**
- Treguet eksportuese: Gjermani, Zvicër, Francë, Danimarkë, Greqi, Kroaci, Maqedoni, Serbi – me plane zgjerimi në Hungari, Austri, Irlandë, Angli, Sloveni etj.

SFIDAT KRYESORE NË EKOSISTEMIN E RICIKLIMIT NË KOSOVË

- **Mungesa e ndarjes në burim të mbeturinave**
  Plastika e papërpunuar dhe e ndotur nga deponitë nuk mund të përdoret për riciklim për arsye shëndetësore dhe teknike.
- **Mungesa e subvencioneve dhe politikave stimuluese**
  Ndryshe nga shtetet fqinje si Serbia apo Mali i Zi, ku kompanitë ricikluese përfitojnë subvencione për ton të riciklur, në Kosovë mungon mbështetja institucionale për sektorin.
- **Paqëndueshmëria e tregut global**
  Çmimet e materialeve të ricikluara luhatën ndjeshëm, duke ndikuar aftësinë për planifikim afatgjatë dhe stabilitetin financiar të kompanisë.

RËNDËSIA STRATEGJIKE E RICIKLIMIT TË LDP-SË

- **Reduktimi i ndotjes mjedisore**
  Riciklimi i LDP kontribuon në uljen e mbetjeve plastike dhe ndotjes në mjedis.
- **Kursimi i burimeve natyrore dhe energjisë**
  Materialet e ricikluara kursejnë energji dhe lëndë të parë në krahasim me prodhimin e materialeve virgjin.
- **Efikasiteti ekonomik në ndërtimtari**
  Produktet e ricikluara janë më të lira – shpeshherë me diferencë çmimi që kalon 2-fishin – dhe nuk kompromentojnë cilësinë funksionale të përdorimit në sektorin ndërtimor.

PARALELIZMA NDËRMJET TREGUT VENDOR DHE ATIJ NDËRKOMBËTAR: DISKREPANCA DHE MUNDËSITË PËR ZHVILLIM

Industria e riciklimit në Kosovë mbetet në faza fillestare të zhvillimit në krahasim me tregjet e konsoliduara evropiane. Ndërsa kompanitë si **Izolimi Plast** kanë arritur të krijojnë cikle të mbyllura të prodhimit dhe eksportojnë produkte të ricikluara, sfida të tilla si mungesa e infrastrukturës për ndarjen në burim dhe mungesa e politikave fiskale shtuese, e kufizojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm të sektorit.

Sipas raportit **"Kosovo Country Environmental Analysis"** i Bankës Botërore (2022), vlerësohet se çdo vit në Kosovë gjenerohen mbi **70.000 ton mbeturina plastike**, nga të cilat më pak se **10% riciklohen në mënyrë efektive**. Kjo përqindje është shumë më e ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian, ku sipas Eurostat (2023), **41.3% e mbetjeve plastike përpunohen për riciklim**, ndërsa pjesa tjetër trajtohet me incinerim ose depozitim. Në vendet fqinje si Serbia, kompanitë e riciklimit përfitojnë deri në **80 euro për ton të materialit të riciklur**, si subvencion shtetëror, duke rritur ndjeshëm konkurrueshmërinë e produkteve të tyre në tregjet e BE-së. Kjo u theksua edhe në raportin **UNDP Serbia Circular Economy (2021)**. Në mungesë të mbështetjes së ngjashme, kompanitë kosovare përballen me kosto të larta të prodhimit dhe kufizime në investime afatgjata.

POTENCIALI PËR ZHVILLIM DHE REKOMANDIMET POLITIKE

Rasti i **Izolimi Plast** tregon se ekziston një bazë reale për zhvillimin e industrisë së riciklimit në Kosovë. Për të rritur kapacitetet vendore dhe për të përfituar nga trendet globale të qëndrueshmërisë, rekomandohen:

Ngritja e sistemit të ndarjes në burim përmes reformimit të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal dhe qendror.

Futja e subvencioneve shtetërore për kompanitë që riciklojnë dhe eksportojnë materiale të ricikluara.

Përfshirja e sektorit të riciklimit në planet e zhvillimit ekonomik dhe energjetik të Kosovës, duke shfrytëzuar potenciin e tij ndikues ndër vite.

Mbështetja për hulumtim dhe inovacion, sidomos në teknologjitë e pastra për riciklim dhe ripërdorim të plastikës në sektorët të ndryshëm.

KONKLUZË

Industria e riciklimit në Kosovë, edhe pse e pazhvilluar në krahasim me standardet evropiane, përfaqëson një rajon mundësitë më premtuese për zhvillim të qëndrueshëm dhe eksport të qëndrueshëm. Izolimi Plast është një shembull se si çmimet inovacionë dhe investimet strategjike, një ndërmarrje vendore mund të gjenerojë vlerë të shtuar, të ndikojë pozitivisht në mjedis, dhe të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie qarkore. Nëse Kosova synon të afrohet me standardet e BE-së dhe të kontribuojë në objektivat globale të klimës, mbështetja për industri si ajo e riciklimit të LDP-së duhet të jetë përparësi kombëtare